



QENDRA E TRAJNIMEVE &
BURIMEVE PER AVOKIM



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



THE ADVOCATE

Përkrah Organizatat Jo-qeveritare

Vëllimi V • Numri 8 • Tetor 2007

PËRMBAJTJA

Faqe 2

Institucionet qeveritare dhe OJQ-të të bashkëpunojnë ngushtë në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore

Freedom House shpall programin e dhënies së granteve për pajtim të komuniteteve

"Analizë buxhetore e Komunes së Prishtinës për vitin 2006"

Faqe 3

Iniciativa e "Syrit të Vizionit" shndërron lokacionin Zatra në zonë të planifikimit urbanistik të Komunes së Pejës

OJQ-të kërkojnë nga mediat të jenë objektive gjatë fushatës zgjedhore

Masat e ngritjes së mirëbesimit në Kosovë

Faqe 4

Shkolla Virtuale për Dialog, Demokraci dhe Zgjidhje Paqësore të Konfliktit shpall konkurs për gjeneratën e re

Hulumtimi i Save the Children nxjerr në pah botëkuptimet e fëmijëve, përfshirë fëmijë të Kosovës

Takime publike të organizuara nga ATRC

Politikanët informojnë qytetarët e Kosovës për procesin e zgjidhjes së statusit



Shtatë qind e tridhjetë qytetarë kanë marrë pjesë në 12 takime publike në mbarë Kosovën në shtator dhe tetor për tu informuar për statusin

Qytetarë, përfaqësues të qeverisë lokale dhe asaj qendrore, OJQ-ve, mediave dhe sektorit të biznesit në dymbëdhjetë qytete të Kosovës u është ofruar mundësia të informohen dhe të bëjnë pyetje për procesin e zgjidhjes së statusit, gjatë 12 takimeve publike të organizuara nga ATRC dhe Zyra Britanike në muajt shtator dhe tetor.

Takimet janë mbajtur në Drenas, Viti (Pozharan), Gjilan (Bresalc), Malishevë, Ferizaj (Komogllavë), Novobërd, Gjakovë (Skivjan), Skenderaj, Podujevë, Pejë (Vitimiricë), Dragash, dhe

qësuesit e komunitetit ndërkombëtar.

Vendim marrësit vendor dhe diplomatë të huaj u kanë bërë thirrje qytetarëve të jenë të durueshëm dhe të bashkëpunojnë me komunitetin ndërkombëtar në kohën kur zgjidhja e statusit është në fazën përfundimtare.

Pjesëmarrësit patën mundësinë t'u bëjnë pyetje për këtë proces Shefit të Zyrës Britanike në Prishtinë - David Blunt, Alex Laskaris - Zyra Amerikane në Prishtinë, Jonuz Salihaj - Ministër i Drejtësisë, Ardian Gjini - Ministër i Ambientit dhe

Planifikimit Hapësinor, Enver Hoxhaj, Hajredin Kuqi, Fatmir Limaj - PDK, Ahmet Isufi - AAK, dhe Teuta Sahatcia - Ora.

"Nëse pas 120 ditëve nuk arrihet ndonjë zgjidhje, propozimi i Ahtisarit mbetet mundësia më e mirë për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Nuk mund të flas me data mirëpo kjo është faza e fundit dhe statusi i Kosovës dëshirojmë të zgjidhet sa më shpejtë," David Blunt i ka thënë publikut në Drenas më 11 shtator. "Ky proces po ecën në drejtim të duhur me përkrahjen e partnerëve tanë. Dëshirojmë rezultate që do të punojnë për të ardhmen tuaj për të ndërtuar një shoqëri siç ju e doni".

Shqetësimet kryesore të pjesëmarrësve janë përqendruar në "paqartësinë e rezultatit pas 10 dhjetorit, njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, unitetin e ekipit negociator të Kosovës, dhe mungesën e konsensusit ndërkombëtar ndaj statusit të Kosovës".

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Institucionet qeveritare dhe OJQ-të të bashkëpunojnë ngushtë në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore

Publikim i ri

"Analizë buxhetore e Komunës së Prishtinës për vitin 2006"

Organizata joqeveritare "Mileniumi i Ri" ka publikuar një analizë buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2006, iniciativë kjo e përkrahur nga ATRC-ja dhe IREX Programi Kosovar për Shoqëri Civile.

Në prezantimin e këtij publikimi më 1 tetor, përfaqësuesit e Mileniumit të Ri raportuan një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me buxhetin komunal. Sipas publikimit "buxheti i vitit 2006 është 17% më i ulët krahasuar me një vit më parë".

Kjo analizë buxhetore është mbështetur në raportin vjetor të buxhetit për vitin 2006 të publikuar nga Komuna e Prishtinës. Parametrat janë marrë nga plani buxhetor për 2006 duke i krahasuar me vitin e mëparshëm dhe me vitin e ardhshëm, 2007.

Parametrat kryesor të theksuara në këtë publikim fokusohen në planifikimin buxhetor dhe të shpenzimeve në proporcion me shpenzimet e realizuara.

Analiza përfshinë informata mbi planifikimin buxhetor, krahasimin e planifikimit të të hyrave buxhetore për vitin 2005 me 2006, për 2006 me 2007, planifikimi dhe realizimi i të hyrave buxhetore për 2006, shpenzimi i buxhetit, pagat, shërbimet ...

Për publikimin e plotë, kontakti ojqmileniumi@yahoo.com

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) dhe Shërbimi Katolik për Ndihmë (CRS) kanë organizuar gjashtë tryeza të rrumbullakëta në gjashtë qytetet kryesore të Kosovës për adresuar çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore. Tryezat e tituluara "Rëndësia e Shoqërisë Civile në Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore", janë organizuar posaçërisht për organizatat kosovare të shoqërisë civile në rajonin e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës, Prizrenit, Ferizajit dhe Gjilanit.

Kjo iniciativë mbledhi së bashku OJQ-të vendore dhe ekspertë të sferës publike dhe shoqërisë civile për të mësuar më gjerësisht dhe komentuar mbi implementimin e Planit Kosovar të Veprimit për Luftimin e

Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Përfaqësues të kryesive komunale, strehimoreve lokale për viktimat e trafikuar, zyrtarë komunal të

Qendrave për Punë Sociale dhe Njësitit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, OJQ-të lokale, Qendra Juridike e Kosovës kanë qenë pjesëmarrës në tryeza. Qendra Juridike ka prezantuar raportin e monitorimit të Planit Kosovar të Veprimit i cili përfshinë periudhë 18 muajsh.

Tryezat kanë qenë diskutime të hapura për të gjithë pjesëmarrësit të cilët kanë



Tryeza e rrumbullakët e mbajtur në Pejë më 5 shtator

rekomanduar që "institucionet qeveritare dhe OJQ-të të bashkëpunojnë ngushtë në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, prokuroria dhe gjykatat të përfshihen në implementimin e Planit Kosovar të Veprimit, mediat t'u japin më shumë hapësirë dhe t'i mbulojnë çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore ...

Për më shumë informata, kontakti info@advocacy-center.org

Mundësi financimi për OJQ-të

Freedom House shpall programin e dhënies së granteve për pajtim të komuniteteve

Freedom House ka shpallur më 3 tetor Programin Kosovar të Granteve për Pajtimin e Komuniteteve (PKPK) përmes së cilit synohet të arrihet qëndrueshmëria e komuniteteve shumetnike dhe ulja e tensioneve etnike në Kosovë.

PKPK programi, i financuar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), është i fokusuar në përpjekjet e shoqërisë civile me qëllim të gjenerimit të ndryshimeve dhe reformave për të avokuar për pajtim dhe për tu bërë zë i fuqishëm në të



Freedom House do të ndaj grante që promovojnë pajtimin dhe dialogun ndërmjet komuniteteve, gjë që përfshin grante për organizatat e shoqërisë civile në krijimin e koalicioneve avokuese ose rrjeteve për të adresuar tema specifike afatgjate për pajtim ndëretnik.

ardhmen e Kosovës. Qëllimet kryesore të programit janë: përpjekjet për pajtim të komuniteteve dhe ngritja e komunikimit dhe bashkëpunimit ndër-etnik; dhe organizatat e shoqërisë civile të jenë liderë në pajtimin e komuniteteve në Kosovë.

Afati i fundit për dorëzim të projekteve është 5 nëntori, 2007

Për më shumë informata për shpalljen e granteve, format e aplikimit dhe buxhetit, kontakti 038 248 699 ose freedom-house.ks@gmail.com

Projekti për Marrëdhënie Etnike

Masat e ngritjes së mirëbesimit në Kosovë

Projekti për Marrëdhënie Etnike (PME) ka publikuar më 30 shtator një raport për "Masat e Ngritjes së Mirëbesimit në Kosovë".

PME synon "lansimin e një sërë masash në ngritjen e besimit ndërmjet shqiptarëve, serbëve, romëve dhe komuniteteve të tjera etnike në Kosovë në përkrahje të përpjekjeve të vazhdueshme të komunitetit ndërkombëtar për të zgjidhur statusin e Kosovës".

Iniciativa ka filluar në qershor 2006 dhe ka përfunduar në korrik 2007.

Raporti përfshinë shkrime mbi nevojat e komunitetit serb në Kosovë; romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në Kosovë; marrëdhëniet ndëretnike; arsimimi i komuniteteve jo-shqiptare; implementimi i propozimit për zgjidhje të statusit; siguria dhe procesi i statusit; Ballkani si burim i sigurisë dhe stabilitetit në Evropë; ngritja e mirëbesimit gjatë procesit të statusit, etj.

Raportin e plotë mund ta gjeni në:

http://www.per-usa.org/Reports/KS03_Kosovo_Confidence_Building_2007.pdf

Burimi: Projekti për Marrëdhënie Etnike

Zhvillimi lokal urban

Iniciativa e "Syrit të Vizionit" shndërron lokacionin Zatra në zonë të planifikimit urbanistik të Komunës së Pejës

Në Pejë ekzistojnë një sërë lokacionesh (vendbanimesh) joformale. Lokacioni i ashtuquajtur Zatra ka qenë një prej tyre deri në prill 2007 kur organizata jo-qeveritare "Syri i Vizionit" inicoi procesin e planifikimit urbanistik, në partneritet me UN Habitatin dhe Komunën e Pejës.

Tash Zatra është zonë e planifikimit urbanistik brenda Komunës së Pejës si rezultat i përpjekjeve avokuese të kësaj OJQ-je.

Përmes kësaj iniciative, të përkrahur nga ATRC dhe IREX Programi Kosovar për Shoqëri Civile, Syri i Vizionit ka synuar të rris pjesëmarrjen e banorëve të Zatrës dhe kërkesave të tyre në përpilimin e draft planit të prioriteteve për zhvillim urban dhe implementimin e tij.

"Komuna e Pejës nuk ka mbajtur takim konsultativ

me qytetarë për të filluar procesin e planifikimit urbanistik", ka deklaruar Veton Mujaj, drejtor i Syrit të Vizionit.

Kemi organizuar takim me përfaqësues të komunitetit të Zatrës për ti informuar për planin rregullativ urban për këtë vendbanim. Tri lloje të pyetsorëve u janë dorëzuar 350 familjeve (pyetsorët janë fokusuar në gjendjen ekonomike urbane, gjendjen familjare dhe infrastrukturë)", ka shtuar Mujaj.

Rezultatet e hulumtimit janë analizuar, banorët e Zatrës janë informuar, dhe prioritetet e tyre janë reflektuar në planin urbanistik komunal.

Plani për zhvillimin urban të Zatrës si akt ligjor i miratuar nga Kuvendi Komunal i Pejës, i ndalon administratës komunale të jep leje për riparcelim dhe

ndërtim në këtë lokacion në qoftë se nuk është në përputhshmëri me planin, i cili përfshinë hartën e shfrytëzimit të tokës në Zatra.

Syri i Vizionit do të vazhdoj të punoj në identifikimin e vendbanimeve joformale në bashkëpunim me grupet e komunitetit me qëllim të përfshirjes së tyre në planin e zhvillimit urbanistik të Pejës.



Lokacioni Zatra në Komunën e Pejës, Kosovë

Për më shumë informata, kontaktoni vizioni@gmail.com;

Zgjedhjet 2007

OJQ-të kërkojnë nga mediat të jenë objektive gjatë fushatës zgjedhore



Përfaqësues të OJQ-ve vendore dhe mediave diskutuan për rolin e tyre në

zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale të caktuara për 17 nëntor. Ata u takuan më 2 tetor në pres-klubin e organizuar nga IREX Programi Kosovar për Shoqëri Civile dhe Programi për Ndihmë Mediave të mbajtur në ATRC me qëllim të informimit të mediave për rolin e tyre, rëndësinë e raportimit të drejtë dhe risitë në procesin zgjedhor të 17 nëntorit.

Pjesëmarrësit veçuan se mediat dhe OJQ-të kanë rol esencial në procesin

zgjedhor, prandaj është e rëndësishme të raportojnë drejtë për fushatën zgjedhore dhe të transmetojnë te qytetarët rëndësinë e daljes në votime.

"Mediat janë një ndër faktorët kryesor për zgjedhjet të drejta pasi qytetarët shumicën e informatave i marrin përmes mediave", ka pohuar Leon Malazogu nga koalicioni "Demokracia në veprim: Zgjedhjet 2007".

Për më shumë informata, kontaktoni shpantina@irex-kcsp.org

atrc**Executive Director**
RREZE DULI
rreze@advocacy-center.org**Financial & Administration
Manager**
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org**Grant Manager**
KUSHTRIM KALOSHI
kushtrimk@advocacy-center.org**Grant Officer**
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org**Grant Finance Manager**
SAFETA XHEKOVIC
safeta@advocacy-center.org**Training & Consultancy
Services Manager**
DONIKA SALIHU
donika@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**
AFERDITA SURROI
aferdita@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**
KUSHTRIM ISLAMI
kushtrim@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**
NORA SUSURI
nora@advocacy-center.org**Communication & Outreach
Manager**
ARJETA DOROCI
arjeta@advocacy-center.org**IT and Database Manager**
ARSIM KOSUMI
arsim@advocacy-center.org

Shkolla Virtuale për Dialog, Demokraci dhe Zgjidhje Paqësore të Konfliktit shpall konkurs për gjeneratën e re

Rrjeti i Dialogut Nansen ka shpallur konkurs për gjeneratën e shtatë të Shkollës Virtuale për Dialog, Demokraci dhe Zgjidhje Paqësore të Konfliktit.

Të gjithë qytetarët e interesuar (politikanë, aktivistë të OJQ-ve, gazetarë, përfaqësues të qeverive dhe institucioneve lokale dhe rajonale) nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia dhe Kroacia janë të ftuar të aplikojnë. Dyzet pjesëmarrës do të përzgjidhen. Shkolla zgjat tetë javë nga

7 nëntori deri më 25 dhjetor, 2007.

Ligjëratat do tu shpërndahen pjesëmarrësve përmes e-mailit, të cilat janë 4-6 faqe dhe mund të përmblajmë materiale shtesë/lidhje interneti.

Pjesëmarrësit marrin gjashtë ligjëratat në gjashtë javë. Dy javët pas përfundimit të ligjëratave u dedikohen vlerësimit dhe shkrimit të eseve finale.

Pjesëmarrja është pa pagesë. Temat përfshijnë dialogun, zgjidhjen e konfliktit. Ligjëruesit janë ekspertë



Për më shumë informata dhe formën e aplikimit vizitoni:
<http://www.ndnvirtualschool.org>

nga Norvegjia, SHBA dhe Ballkani.

Burimi: Rrjeti i Dialogut Nansen

Hulumtimi i Save the Children nxjerr në pah botëkuptimet e fëmijëve, përfshirë fëmijë të Kosovës

Organizata ndërkombëtare joqeveritare "Save the Children" ka kryer një hulumtim të gjerë tereni në 7 vende/entitete të Evropës Juglindore, duke folur me 600 fëmijë përmes intervistave individuale. Hulumtimi përfshinë diskutime me fokus-grupe mbi atë se si ata i perceptojnë rreziqet e trafikimit dhe përdorimit, cilat janë fuqitë e tyre dhe mekanizmat që përballen, dhe si shteti dhe shoqëria civile mund të sigurojnë mbrojtje dhe asistencë më të mirë për fëmijët në rrezik. Rezultatet e hulumtimit janë publikuar në raportin "Fëmijët flasin hapur" të publikuar

më 18 shtator në Parlamentin Evropian në Bruksel.


Hulumtimi i Save the Children synon të mësojë më shumë për çfarë shkakton që disa fëmijë të jenë më të rrezikuar ndaj trafikimit sesa të tjerët, dhe se si përpjekjet dhe intervenimet për të parandaluar trafikimin e fëmijëve mund të përpilohen për ti ndihmuar dhe mbrojtur më mirë këta fëmijë. Raporti "Fëmijët flasin hapur" po ashtu synon t'i informoj bërësit e politikave kombëtare dhe rajonale, OJQ-të dhe shoqërinë civile mbi atë se çfarë ndryshimesh kërkohen për

t'i përbushur nevojat e fëmijëve të rrezikuar nga trafikimi. Raporti dokumenton rëndësinë e të dëgjuarit të fëmijëve dhe shqyrtimit të mendimeve të tyre.

Shqipëria, Bosnja & Hercegovina, Bulgaria, Mali i Zi, Kosova, Rumania dhe Serbia kanë qenë pjesë e hulumtimit.

"Fëmijët flasin hapur" mund të shkarkohet nga webfaqja e Save the Children: http://www.savethechildren.net/alliance/what_we_do/newsdesk/2007-09-18.html

Burimi: Balkan Academic News



—Gjatë një viti të fushatës globale, Save the Children ka përmirësuar shkollimin për 3.4 milion fëmijë

Artistë të njohur të Hollywoodit i kanë dhuruar \$1 milion Save the Children

